



**VENDIM**

***Nr. 55 Datë 02.05.2012***

**PËR**

**MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHIT – BLERJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SH.A DHE SHOQËRISË “HEC  
ULËZ – SHKOPET” SH.A**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 4 të Modelit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.05.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe kontratën e shit – blerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a dhe shoqërisë “Hec Ulez - Shkopet” sh.a,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria KESH sh.a është licencuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 11 datë 23.06.2006, i ndryshuar.
- Shoqëria “Hec Ulëz Shkopet” është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, dhe me vendimin nr. 133, datë 06.12.2011 është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 date 19.03.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 154 date 07.12.2011 “ Për përcaktimin e tarifës se

prodhimin të energjisë elektrike nga “Hec Ulëz – Shkopet” për periudhën e tretë rregullatore.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

### **Vendosi :**

1. Miratimin e kontratës me nr. 1259 Prot., datë 23.03.2012 të shit – blerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a dhe shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.